



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS**  
**FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE-NATYRORE**  
**Departamenti i Biologjisë**

**Mirlinda Mazreku**

Titulli i punimit:

**FLORA VASKULARE NË FRAGMENTET PYJORE DHE  
SHKURRORE NË RRETHINËN E QYTEZËS SË MALISHEVËS**

Punim i Masterit

Prishtinë, 2026



**UNIVERSITY OF PRISHTINA**  
**FACULTY OF MATHEMATICAL-NATURAL SCIENCES**  
**Department of Biology**

Candidate:

**Mirlinda Mazreku**

Title:

**Vascular flora in the forest and shrub fragments in the  
surroundings of the town of Malisheva**

Master Thesis

Prishtinë, 2026



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS**  
**FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMETIKE-NATYRORE**  
**Departamenti i Biologjisë**

Kandidat:  
**Mirlinda Mazreku**

Titulli i punimit:  
**Flora vaskulare në fragmentet pyjore dhe shkurrenë në rrethinën e  
qytezës së Malishevës**

Punim i Masterit

Mentor:  
**Prof. Dr. Elez Krasniqi**

Prishtinë, 2026

## 11. REZYME

Ky hulumtim u realizua me qëllim të identifikimit dhe evidentimi i llojeve bimore të florës vaskulare në fragmentet pyjore dhe shkurre në kuadër qytezës së Malishevës me rrethinë, konkretisht në zonën kadastrale të qytezës së Malishevës.

Fragmente pyjore dhe shkurre hasim kudo në territorin e Republikës së Kosovës. Ato janë prezente ende edhe në territorin e qytezës së Malishevës me rrethinë. Këto fragmente paraqesin pjesë të diversitetit bimor të mbetur nga e kaluara dhe janë tregues për të kaluarën e bimësisë apo vegetacionit në këto zona.

Qyteza e Malishevës gjendet në pjesën qendrore të territorit administrative të komunës me emër të njëjtë-Malishevë, ndërsa gjendet poashtu në pjesën qendrore të Kosovës. Zona ka klimë kontinentale përderisa reshjet mesatare vjetore janë 684 mm dhe temperatura mesatare vjetore sillet rreth 11.2<sup>0</sup>C (Islami, H. etj. 2018). Sa i përket gjeologjisë, zona është pjesë e basenit kenozoik të Mirushës dhe njësisë së Pagarushës të moshës së kretakut. Në aspektin pedologjik, tokat janë të ndryshme. Në zonë, pothuaj se përmes saj, kalon lumi Mirushë i cili shkarkohet në lumin Drini i Bardhë (Zogaj, I. 2010, Islami, H. etj. 2018).

Zona kadastrale e Malishevës është e kufizuar me zonat kadastrale Carrallukë, Banjë, Marali, Dragobil dhe Mirushë. Ka sipërfaqe prej 842.6 hektarë prej të cilave 482 hektarë janë ara, 199 hektarë pyje, 118 livadhe dhe kullosa dhe 41 hektarë janë djerrina (Islami, H. etj. 2018). Bazuar në të dhënat paraprake (Osmani, J. 2006), por edhe në bazë të gjendjes aktuale, Malisheva përbëhet nga lagjet-familjet: Branki (më e vjetra), Matoshi, Mekaj (Kryeziu), Veselaj, Canaj dhe Minolli.

Pyjet dhe shkurret janë fragmentare dhe janë me rendësi në aspektin e biodiversitetit dhe të peizazhit të zonës. Këto janë pjesë të bimësisë-vegjetacionit të cilat së bashku me vegjetacionin e livadheve, kullotave, vegjetacionin ruderal dhe atë të agroekosistemeve e përbëjnë një tërësi.

Sipas metodologjisë së hulumtimit të vegjetacionit nga Braun Blanquet 1964 (Rexhepi, F. 1994), bazuar në gjendjen në terren, zona kaastrale e Malishevës mbulohet nga vegjetacioni i pyjeve dhe shkurreve gjetherënëse ku kemi dominim të llojeve të dushkut në (pjesët kodrinore), vegjetacioni pyjor-shkurre me dominim të shelgjeve përgjatë rrjedhës së lumit Mirushë dhe rrjedhave tjera më të vogla (në pjesën e ultësirës), vegjetacioni i livadheve të ultësirave, vegjetacioni i kullotave, vegjetacioni ruderal (afër vendbanimeve) dhe vegjetacioni i agroekosistemeve.

Pyjet dhe shkurret gjetherënëse në pjesët kodrinore shtrihen si mbulesë bimore-vegjetacione në formë të fragmenteve. Ato janë mbetje e vegjetacionit natyror në të cilat dominojnë llojet e dushkut (*Quercus frainetto*, *Quercus cerris*, *Quercus pubescens* dhe më rrallë ndonjë individë i *Quercus petraea*) të shoqëruara me lloje tjera bimore të cilat rriten në pyjet gjetherënëse të dushkut.

Fragmentet pyjore-shkurrore ku dominojnë shelgjet të shoqëruara nganjëherë edhe me plep dhe lloje tjera, shtrihen kryesisht përgjatë rrjedhës së lumit Mirushë. Kjo bimësi-vegjetacion përbëhet kryesisht prej disa llojeve të shelgjeve (dominon *Salix alba* ndërsa llojet tjera më rrallë) të shoqëruara ndonjëherë edhe me plep (*Populus* sp.), përderisa lloje tjera bimore janë lloje që rriten përgjatë rrjedhave ujore.

Poashtu vegjetacioni i livadheve, i kullotave, vegjetacioni ruderal dhe ai i agroekosistemeve kanë shtrirje në zone me mbulueshmërinë e tyre bimore.

Edhe në territorin e qytezës së Malishevës, sikur edhe në zona tjera në Kosovë, faktori antropogjen bënë aktivitete të vazhdueshme. Këto veprime (direkte apo indirekte) kanë tendencë për ta ndryshuar gjendjen e ekosistemeve e habitateve të ndryshme, përfshirë edhe zonat ku shtrihen pyjet dhe shkurret. Ndikimi i vazhdueshëm antropogjen në aspektin negative në raport me

mjedisin jetësor dhe natyrën në radhë të parë shprehet përmes ndërhyrjeve-dëmtimimeve në shtratin e lumit Mirushë dhe të rrjedhave tjera ujore. Poashtu shqetësuese janë edhe ndërhyrjet dhe si pasojë zvoglimi i sipërfaqeve pyjore dhe shkurre fragmentet e mbetura të ekosistemeve natyrore, hudhja ilegale e mbeturinave, shkarkimi i ujërave të ndotura, zgjerimi i vendbanimit përmes ndërtimeve të shtuara përmes zhvillimit urban, etj.

Zhvendosja e pullsisë nga zonat rurale dhe si pasojë rritja e popullsisë në qytezën e Malishevës ka rezultuar me zhvillime urbanistike sidomos pas luftës së fundit (pas vitit 1999). Ky zhvillim i shpejtë në zonën urbane të qytezës, në veçanti në dekadën e fundit, sjell ndryshime të theksuara të cilat ndikojnë në zvoglimin e zonave natyrore duke i përfshirë edhe fragmentet e mbetura të pyjeve dhe shkurreve si pjesë e rendësishme për biodiversitet, peizazh, rekreacion dhe për shëndetin e qytetarëve të qytezës.